



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 30.07.2013
Nr. 0204 - 987

PËR: Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SHTIMES, Npi. 01/164, Pranuar me datë, 24.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Npi. 01/164, të miratuar me datë 01.07.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Npi. 01/164 për refuzimin e ankesës, 01 Nr. 016/4476 të Tahir Kokollari nga Shtimja.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 30.07.2013
br. 0204 - 987

Za: Naim Ismajli, Gradonačelnik opštine Štimlje
Kujtim Xhelili, Predsedavajući Skupštine opštine Štimlje

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Štimlje, Npi. 01/164, Primitjeno dana ,
24.07.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke Npi. 01/164, odobreno dana 01.07.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka Npi. 01/164 o odbijanju zahteva , 01 br. 016/4476 Tahir Kokollari iz Štimlja.

Sa poštovanjem.

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr.006/4728, Datë: 25.6.2013



Npi – 01/164, Datë: 1.7.2013

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër: 01Nr.016/4476, të datës:20.6.2013, të z.Tahir Kokollarit, përfaqësues i firmës NP.“Etlinger” – Shtime, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal – Shtime, që të ndryshohet vendimi i mëparshëm i Kuvendit Komunal me numër 01Nr.06/1011-185, i datës:18.5.2009, me të cilin palës i është dhënë në shfrytëzim prona e pa luajtshme Komunale prej 70 ari, në afat prej 10 viteve. Tani pala kërkon që ky vendim të ndryshohet dhe ti epet për afat më të gjatë kohor sipas Ligjit për Dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme Komunale me numër Nr.04/L-144 të datës:22.11.2012. me arsyetimin se afati i shkurtër kohor është pengesë për të fituar, Kredi ose donacione, me qëllim të shtimit të kapaciteteve dhe investimeve në këtë biznes. Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M


PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, 01Nr.016/4476
TË TAHIR KOKOLLARI NGA SHTIMJA

I

Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e gjashtë të rregullt për vitin 2013, të mbajtur më datën: 1.7.2013, me shumicën e votave ka vendosur që të refuzoi kërkesën me numër: 01Nr.016/4476, të Tahir Kokollarit, përfaqësues i firmës NP.“Etlinger” – Shtime, me arsyetimin se jemi në fazën e kompletimit të dokumentacionit për shpalljen e Zonës Ekonomike, për lokacionin ku pala e ka vendosur biznesin.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili